

VEPRIMTARI PËRURUESE E BOTIMEVE SHKENCORE TË IGJL (ASA)

Në kuadrin e Ditës botërore të librit dhe të drejtës së autorit, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike, në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave Shoqërore të Universitetit të Shkodrës, organizuan më 26 prill 2022 promovimin e revistës shkencore “Studime filologjike” (botim i IGJL-ASA), si edhe paraqitjen e veprave të përgatitura nga punonjësit shkencorë të institutit, në kuadrin e kontratës së tyre individuale shkencore.

Përmbajtja e detajuar e numrave 1-2, 2019 u paraqit nga prof. dr. Anila Omari, sekretare shkencore e redaksisë së revistës “Studime filologjike”, ndërsa numrat 3-4, 2019 u paraqitën nga prof. as. dr. Evalda Paci, zv-kryeredaktore e saj.

Drejtoresha e Qendrës së Studimeve Albanologjike, të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Dr. Zamira Shkreli, në përshëndetjen e saj përgëzoi miqtë e ftuar dhe të pranishmit për faktin që zgjodhën Shkodrën dhe Universitetin “Luigj Gurakuqi”, për punën e përkushtuar në shërbim të albanologjisë dhe shoqërisë me prurje të vlerta. Ajo u shpreh ndër të tjera se “këtë takim e shohim si një mundësi për të rritur bashkëpunimet tona dhe këtu gjej rastin për të shprehur vlerësimet e mia për të gjithë ata studiues, kërkues shkencorë dhe pedagogë që i shërbejnë arsimit, shkencës dhe kulturës shqiptare.”

Prof. Valter Memisha, zv. rektor i ASA-s theksoi ndër të tjera në përshëndetjen e tij se “promovimi i sotëm përbën një sendërtim e vënie në jetë të marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet dy institucioneve për bashkëpunim të dyanshëm e shumëdrejtimësh:

ASA krijon një produkt shkencor të rëndësishëm, elitar, që shkon me një mesatare vjetore rreth 40 – 50 tituj shkencorë që përfshijnë studime në antropologji, art, etnologji, folklor, arkeologji, gjuhësi, histori, letërsi, enciklopedi etj. Tipologjia e botimeve përfshin vepra shkencore përgjithësuë kolektive, fjalorë, monografi, përmbledhje studimesh, botime dokumentesh të gjurmara në biblioteka e arkiva shqiptare, evropiane e më gjerë, botime të akteve të konferencave, botime enciklopedike albumesh etj. Paraqitja e sotme është thellësisht shkencore sepse merr për herë të parë opionencën shkencore të specializuar të kolegëve të Universitetit të Shkodrës, domethënëse për të gjithë ne. Kjo nismë mishëron mëtimin dhe detyrimin tonë shkencor që ky produkt shkencor mos të flejë, mos të jetë mbushës i raftet të bibliotekave e ta mbulojë

pluhuri, por të shkojë drejtpërdrejt pranë studiuësve, pranë studentëve e pranë të interesuarve”.

Në emër të FSHSH (USH) përshëndeti dekani i këtij fakulteti, prof. Artan Haxhi, i cili vlerësoi se “veprimtari të tilla shkencore tashmë janë bërë një traditë e bukur dhe mjaft e vlefshme për të dyja institucionet; vetë qëllimi i organizimit të këtij aktiviteti i shërben më së miri procesit promovues të shkencës në përgjithësi, por në të njëjtën kohë shërben edhe për të diskutuar së bashku rreth problemeve të gjuhësisë shqiptare, mundësive dhe domosdoshmërisë që ajo t’u përshtatet sa më mirë kërkesave të kohës. Ai e konsideroi tubimin si një mundësi e shkëlqyer për të forcuar lidhjet dhe bashkëpunimin shkencor midis dy institucioneve, bashkëpunim që nuk është nuk është thjesht i sotëm, por për hir të së vërtetës i ka rrënjët që herët, si edhe një mundësi promovimi të punës shkencore që ndihmon në mënyrë të pazëvendësueshme në zhvillimin e qëndrueshëm në të ardhmen.”

Prof. Artur Lama në bashkëpunim me ma. E. Karaj paraqitën referatin “Rreth ecurisë shkencore në IGJL”. Në këtë referat u sollën arritjet dhe prioritetet e punës shkencore (botimet, konferencat, lektoriumet, projektet etj.)

Prof. as. dr. Orjeta Baja paraqiti një analizë mbi veprën e prof. Valter Memisha, “Studime për fjalën shqipe”, vëllimi 5. Për të “kjo vepër vjen si përvijim në të njëjtën linjë i vëllimeve pararendëse të serisë me përmbledhje studimesh të gjuhëtarit Valter Memisha. Punimi sjell trajtime tejet analitike nga autori, në lidhje me fjalën si njësi e leksikut dhe fjalën si njësi leksikografike; duke iu referuar gjuhës së disa personaliteteve të spikatura në kulturën tonë kombëtare dhe kontributit të disa personaliteteve të gjuhësisë për leksikografinë e gjuhës shqipe. Pjesën e parë të punimit, studiuësi ia kushton: paradigme shumëplanëshe të gjuhës së disa personaliteteve për gjuhën shqipe, si: Dritëro Agolli e Midhat Frashëri; leksikografisë shqipe në mjedisin arbëresh të Sicilisë përmes punës së akademikut Matteo Mandalà; dukurisë së koherencës leksikore në formimin e fjalëve përmes veprimtarisë së Lasgush Poradecit. Objekt i pjesës së dytë bëhen personalitete të leksikologjisë shqipe, duke iu referuar kontributit me vlerë të disa prej tyre, si: Shefkije Islamaj, Anila Omari e Abdullah Zymberi, dëshmuar përmes interpretimeve e analizave skrupuloze të veprave të tyre nga autori. Punimi mbyllet me rubrikën *Të ndryshme*, ku shpaloset qartë synimi e dëshira e prof. Memishës për një certifikim evropian të gjuhës shqipe. Botimi shfaq dukuri gjuhësore me vlerë për t’u trajtuar më tej në fushën e kërkimeve gjuhësore shqiptare, në veçanti të asaj leksikore e semantike.”

Ndërsa dr. Anisa Kosteri kishte si objekt të shqyrtimit të saj veprën “Pasuri të ligjërimit shqip II” (vështrime leksikore dhe etnosociolinguistike) të prof. dr. Artur Lamës. Ajo e vuri theksin mbi faktin se “veprat e autorëve të mëdhenj, studiuësve të fjalës shqipe, prej kohësh kanë tërhequr vëmendjen dhe janë bërë objekt studimi, jo vetëm i kritikëve të letërsisë e historianëve, por

edhe nga gjuhëtarët, të cilët kanë ndeshur aty përpjekjet e shumta, mundin e dëshirën për dëshmimin e fjalës shqipe dhe të frazeologjisë popullore, traditës e zakoneve të kombit shqiptar, gjithnjë përmes forcës së fjalës dhe konotacionit të saj. Duke u nisur nga ky këndvështrim, prof. Artur Lama, ka bërë një analizë mjaft të thukët shkencore të leksikut të pasur, duke pasur si qëllim, siç shprehet edhe vetë ai, se studiuesi por edhe lexuesi i thjeshtë nxjerr në pah raportin midis gjuhës dhe fjalorit të saj, jep karakteristika për personalitetin gjuhësor të një grupi a etnie të caktuar, vizionin kulturor e gjykimin semantik të një bashkësie shqiptare për sendet e dukuritë që i shfaqen në jetën e përditshme, duke përfshirë këtu edhe rastin e shqipes, e cila jeton në situatën e gjuhëve në kontakt.”

Për prof. as. dr. Rrezarta Draçinin vepra “Aspekte të gjuhësisë së zbatuar 3”, me autor prof. Tomorr Plangarica, “është një prurje me risi shumë interesante në serinë e studimeve gjuhësore, që sjell një qasje të re të shqipes përballë studimeve bashkëkohore në fushën e gjuhësisë.

Gjuhësia e zbatuar është një disiplinë e re e institucionalizuar vonë në mendimin gjuhësor botëror, ndaj nevoja e përfshirjes së shqipes në lëmin e këtyre studimeve është një dosmodoshmëri. Prof. Tomorr Plangarica e ka nisur prej vitesh punën e tij shkencore në fushë të gjuhësisë së zbatuar, duke mundësuar dhe qasjen e shqipes me këtë këndvështrim, duke dhënë një kontribut me shumë vlerë për studimin e saj. Suksesi i prurjeve të prof. Plangaricës lidhet ngushtë me formimin e tij teorik, sipas shkollave evropiane, kryesisht asaj franceze. Këtë formim bashkëkohor teorik prof. Plangarica ka arritur ta ndërthurë shumë mirë me studimet e shqipes dhe ta përfshijë vetë shqipen brenda këtyre teorive, që lidhen kryesisht me shkencat e ligjërimit dhe gjuhësinë e zbatuar. U theksua gjithashtu që kjo përmbledhje studimesh është një vlerë e shtuar për studimet në fushën e gjuhësisë dhe shqipes në veçanti, duke dhënë mundësi të reja këndvështrimesh.”

Dr. Erzen Koperaj, në analizën e tij mbi përmbledhjen studimore të Evalda Pacit (Botime Françeskane, Shkodër, 2020) theksoi ndër të tjera: Vëllimi me titull “Gjurmime filologjike mbi latinitetin dhe shkrimet e vjetra shqipe” i autores Evalda Paci vjen si një përmbledhje e dymbëdhjetë shkrimeve të cilat rrokin në vetvete çështje të romanitetit dhe filologjisë latine, të reflektuara këto edhe në studimet mbi tekstet e vjetra të shqipes së shkruar, të trajtuara në mjaft raste si argumente që hedhin dritë mbi vetë historinë e shqipes. Tematika e shkrimeve ngrihet mbi dy linja, latinitetin dhe autorët e vjetër, ku ndër këta të fundit spikat Buzuku me “*Mesharin*”. Përmes qasjeve ndër-gjuhësore, autorja ofron një fushë gjurmimesh duke u ndalur në përdorime të veçanta që krahasimi mes teksteve i vë në dukje. Megjithëse shkrimet e paraqitura qëndrojnë të plota në vetvete, ato lidhen dhe vijojnë në mënyrë harmonike argumentet e njëri-tjetrit, dhe më shumë të japin përshtypjen e kapitujve të një të tëre, sesa si shkrime të veçanta .

Paraqitja e radhës që ajo e dr. Zamira Shkrelit mbi veprat “Fjalor i Gjuhës Shqipe” 5-11 vjeç, i ilustruar, “Fjalor i gjuhës shqipe” 12+” me autorë prof. as. dr. Anila Kananaj, prof. dr. Shezai Rrokaj. “Dy veprat e reja që promovohen sot vijnë si një risi për leksikografinë shqiptare dhe janë sjellë nga dy studiues prof. as. dr. A. Kananaj dhe prof. dr. Sh. Rrokaj, të cilët përmes një pune të përkushtuar e skrupuloze ofruan pranë lexuesit shqiptar, por jo vetëm, dy fjalorë: “Fjalori i gjuhës shqipe” i ilustruar moshë 5-11 vjeç dhe “Fjalor i gjuhës shqipe” moshë 12+.

Fjalorët janë një mjet i nevojshëm për zhvillimin e gjuhës dhe gjithashtu të kuptuarit e botës që rrethon këto fasha moshore, që nuk është aspak e lehtë t’ua shpjegosh në mënyrë të qartë e të kuptueshme kuptimet e fjalëve. Autorët kanë marrë përsipër të sjellin me shumë përgjegjësi botime të tilla që sqarojnë lexuesin (nxënës). Fotot dhe ilustrimet mjaft interesante, vizatimet origjinale plot ngjyra që përshkruajnë kuptimet konkrete të fjalëve, pasurojnë këtë fjalor dhe e bëjnë atë të dashur për lexuesin (fëmijë), duke pasur gjithnjë parasysh që kjo grupmoshë preferon të perceptojë edhe përmes syrit. Mendojmë se shkolla jonë e kishte të domosdoshme pasjen e veprave të tilla.”

Në analizën e tyre, prof. dr. Mimoza Prikur dhe prof. dr. Tomor Osmani theksuan se monografia “Gjedhet e eptimit foljor në gjuhën shqipe” e gjuhëtarit Leonard Dauti përfaqëson një model të klasifikimit të foljeve në gjuhën shqipe bazuar në teori bashkëkohore që kanë si bazë rrafshin morfologjik. Për analizën dhe hartimin e parimeve teorike autorin e ka ndihmuar korpusi i foljeve të gjuhës shqipe dhe gjithashtu tri burime teorike modelesh gramatikore: standard-toskërisht-gegërisht. Ai ka sjellë modelet e zgjedhimeve dhe ka bërë një pasqyrë të plotë të zgjedhimit të foljeve sipas modeleve të propozuara.”

Dr. Merita Hysa dhe dr. Rezearta Murati në shqyrtimin e tyre vunë theksin mbi faktin se: Struktura e monografisë “Ndikimi gjuhësor në kontaktin mes dy gjuhëve – Rasti i shqipes me italishten” i studiueses dr. Valbona Sinanaj paraqet një organizim tërësor, i cili prek disa aspekte metodologjike. Gërshetimi i mendimit teorik tradicional, me atë bashkëkohor për konceptin e të folurit, krijon një kuadër të gjerë teorik të funksionit të tij në shoqëri. Duke krahasuar qasjet teorike nga Humboldti, e deri te Chomsky, autorja na jep perspektivën e zhvillimit të mendimit gjuhësor në lidhje me dinamikën sociale të bashkësive. Aspekti metalinguistik i gjuhës shihet si një substrat simbiotik, i lidhur në mënyrë të ngushtë me funksionimin e organizimit shoqëror, në pikëpamje sociale, etnologjike, psikologjike, etj.

Me interes në punim është edhe korpusi gjuhësor i të dhënave, të cilat studiuesja i ka mbledhur nga intervistat me folës aktivë. Duke ndërthurur karakterin përshkrues, krahasues dhe analizues, monografia na jep një tablo të qartë jo vetëm të dukurive gjuhësore që ndeshen në situatën e bilinguizmit (në pikëpamje fonologjike, por jo vetëm), por edhe të qasjeve ndaj proceseve sociolinguistike që shoqërojnë këto përballje.”

Prof. as. dr. Arben Prendi mori në analizë monografinë “Publicistika e Lazër Shantojës, paradigmë shqiptare e mendimit modern” (2021) me autore studiuesen e Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, ma. Rafaela Marteta. Ai theksoi ndër të tjera se autorja ka meritën se bën objekt studimi një pjesë të veprës së njërës prej autorëve të rëndësishëm në kulturën shqiptare, i cili për arsye ideologjike është lënë në harresë, jo vetëm gjatë periudhës së regjimit komunist, por edhe pas rënies së tij, me sa duket, për shkak të të njëjtit paragjykim.

Pra, autorja Rafaela Marteta ka vënë në fokus të punimit, publicistikën e Shantojës si pjesë, por edhe si shprehëse dhe ushqyese idesh e konceptesh; si përçuese e mendimit dhe ndjeshmërisë moderne në rrethanat e formësimit të vetëdijes sociale dhe kulturore të shoqërisë shqiptare të gjysmës së parë të shek. XX.”

Në këtë tubim shkencor mori fjalën edhe prof. A. Çapaliku, i cili përveçoi vlerën që ka gjuha shqipe në perceptimin dhe kënaqësinë estetike të disa poezive botërore. Në fund u dhuruan libra për bibliotekën e Universitetit të Shkodrës, si dhe për departamentet e Fakultetit të Shkencave Shoqërore. U rishtua dhe në përmbyllje të kësaj veprimtarie të përbashkët nevoja e vijimësisë së bashkëpunimit ndërinstytucional, e reflektuar dhe në këtë ditë të plotë studimore, që forcoi më tej ndërveprimin mes IGJL dhe Fakultetit të Shkencave Shoqërore të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.

Evalda Paci

